



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.102

2 gusht

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MASH nr.9, datë 18.2.2011	Për procedurat e njehsimit të dëftesave/diplomave të shkollave të mesme dhe regjistrimin në Maturën Shtetërore 2011 të shtetasve shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit 4079
Udhëzim i MASH nr.15, datë 6.4.2011	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.5, datë 18.2.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”..... 4080
Udhëzim i MASH nr.17, datë 5.5.2011	Për masat për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2011..... 4081
Udhëzim i MASH nr.18, datë 11.5.2011	Për masat për zhvillimin e provimeve të lirimimit 2011..... 4083
Urdhër i METE nr.449, datë 21.6.2011	Për mënyrën e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave dhe të dokumentacionit shoqërues të shoqërive që do të pajisen me leje për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit..... 4083
Urdhër i METE nr.478, datë 27.6.2011	Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së vendimeve të këshillave teknikë të institucioneve të SHGJSH-së dhe AKBN-së për aplikimet e lejeve minerare, për shtyrjen e afatit të lejeve minerare dhe për shndërrimin e lejeve minerare të kërkim-zbulimit në leje minerare shfrytëzimi..... 4085

UDHËZIM
Nr.9, datë 18.2.2011

PËR PROCEDURAT E NJEHSIMIT TË DËFTESAVE/DIPLOMAVE TË SHKOLLAVE TË MESME DHE REGJISTRIMIN NË MATURËN SHTETËRORE 2011 TË SHTETASVE SHQIPTARË QË KANË KRYER ARSIMIN E MESËM JASHTË SHTETIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shtetasit shqiptarë që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë shtetit, kanë të drejtë të vazhdojnë programet e studimit në institucionet e arsimit të lartë (IAL) me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme në Republikën e Shqipërisë, me kusht që të zotërojnë gjuhën shqipe në një nivel të pranueshëm për të vijuar studimet universitare. Zotërimi i gjuhës shqipe vërtetohet nëpërmjet dëshmisë së provimit, që zhvillohet mbi bazën e programit për të huajt pranë Fakultetit të Histori-Filologjisë në Universitetin e Tiranës. Procedura e dhënies së provimit të gjuhës shqipe, programi dhe tarifa e këtij provimi, përcaktohen nga Fakulteti Histori-Filologjisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Koha e dhënies së provimit të gjuhës shqipe pranë Fakultetit të Histori-Filologjisë, është brenda muajit maj 2011.

2. Nga detyrimi i dhënies së provimit të gjuhës shqipe përjashtohen të gjithë ata shtetas, të cilët kanë vazhduar studimet në shkollën e mesme në institucione arsimore, që kanë program mësimor në gjuhën shqipe, ose ata shtetas që e japin gjuhën shqipe dhe letërsinë si provim të detyruar të Maturës Shtetërore.

3. Ministri i Arsimit dhe Shkencës ngre një komision të posaçëm pranë MASH-it për të shqyrtuar kërkesat e shtetasve shqiptarë, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit.

4. Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, paraqesin pranë komisionit të posaçëm, nga data 1 deri më 15 prill, dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën me shkrim për të vazhduar një program studimi në IAL;
- dëftesën/diplomën origjinale së bashku me listën e notave të të gjitha viteve të shkollës së mesme, të përkthyer dhe të noterizuara;
- kopje e noterizuar e pasaportës ose e kartës së identitetit;
- dokument zyrtar nga vendi që vjen, i cili vërteton se cikli i studimeve të kryera nga shtetasit shqiptarë në atë vend dhe profili i shkollës së mesme që kanë përfunduar, u japin të drejtën të vazhdojnë studimet universitare ose shkolla të larta jouniversitare në vendin ku kanë studiuar.

5. Në rastet kur komisioni i posaçëm vlerëson se shtetasit shqiptarë, që kanë kryer arsimin e mesëm jashtë vendit, nuk kanë dhënë provimet ekuivalente me Maturën Shtetërore (D1, D2, Z1 dhe Z2), për t'u pranuar në IAL, shtetasit duhet:

a) të japin si provime të detyruara gjuhën shqipe e letërsinë dhe matematikën, ose një nga gjuhët e huaja të listës së lëndëve me zgjedhje, e konceptuar sipas standardit të testit të gjuhës shqipe dhe letërsisë (D1), si dhe provimet me zgjedhje sipas procedurës së përcaktuar në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2011 në Republikën e Shqipërisë”;

b) pas përfundimit të detyrimeve të përcaktuara në pikën 5.a të këtij udhëzimi, shtetasi shqiptar që ka kryer arsimin e mesëm jashtë vendit, pajiset me një certifikatë të dhënies së provimeve të detyruara dhe të atyre me zgjedhje. Ky dokument lëshohet nga Agjencia Kombëtare e Provimeve.

6. Në rastet kur komisioni i posaçëm vlerëson se dokumentet shkollore të shtetasve shqiptarë, nuk provojnë dhënien e provimeve me zgjedhje të Maturës Shtetërore, por vetëm ato me detyrim, D1 dhe D2, atëherë ky komision përlllogarit notën mesatare të viteve të shkollimit dhe nota e provimeve të detyruara D1 dhe D2. Në këtë rast, shtetasi shqiptar është i detyruar të japë vetëm provimet me zgjedhje.

7. Komisioni, pasi njezh vlefshmërinë e dëftesës/diplomës shkollore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur, përcakton provimet që do të japë shtetasi shqiptar sipas rasteve të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij udhëzimi dhe përcjell zyrtarisht dokumentacionin në KMSH-në e DAR/ZA-së ku shtetasi shqiptar ka vendbanimin, deri në datën 30 prill 2011.

8. KMSH-së e DAR/ZA-së i përcjell këto të dhëna në AKP dhe cakton shkollën ku kandidati do të japë provimet e Maturës Shtetërore.

9. Formularët A1Z të plotësuar nga kandidatët për të cilët bën fjalë ky udhëzim, dorëzohen zyrtarisht nga DAR/ZA në AKP, së bashku me përmbledhësen e të dhënave të tyre, brenda datës 5 maj 2011.

10. Shtetasit shqiptarë që duan të studiojnë në programet e studimit të IAL-së me kohë të pjesshme, përveç kriterëve të parashikuara nga ky udhëzim, u nënshtrohen edhe kriterëve të parashikuara nga udhëzimi i posaçëm i MASH-it për këto programe studimi.

11. Në rastet kur komisioni i posaçëm vlerëson se shtetasi shqiptar i ka kryer të gjitha detyrimet e Maturës Shtetërore dhe ka dhënë edhe provime pranimit për në universitetet ose shkollat e larta jouniversitare të vendit nga ku ai vjen, atëherë komisioni përllogarit notën mesatare, notat e provimeve të detyruara dhe me zgjedhje, dhe ia përcjell dokumentacionin Agjencisë Kombëtare të Provimeve. Në këtë rast, shtetasi shqiptar do të vijojë plotësimin e dokumentacionit me formularin A2, pranë KMSH-së së DAR/ZA-së ku ka vendbanimin e tij.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Drejtoria e Bashkëpunimit Internacional, Drejtoria e Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.15, datë 6.4.2011

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 18.2.2009 “PËR
PËRMBAJTJEN DHE FORMËN E DIPLOMËS SË LËSHUAR NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT
TË LARTË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 31 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin nr.5, datë 18.2.2009 “Për përmbajtjen dhe formën e diplomës së lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë”, të bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Emërtimi i diplomës së lëshuar, sipas programeve të miratuara të studimit dhe cikleve të studimit, të jetë:

a) “Bachelor” në ... (fusha e arsimit të kryer);

b) “Master i shkencave” ose “Master i arteve të bukura” në... (fusha e arsimit të kryer);

c) “Master profesional” në ... (fusha arsimit të kryer).

2. Pas shkronjës “l” të pikës 4, shtohet shkronja “m”, si më poshtë:

“m. Formën e studimeve.”.

3. Pas pikës 4 shtohen pikat 4.1 dhe 4.2, si më poshtë:

“4.1 Diploma universitare “Bachelor” e secilit student, duhet të përmbajë edhe ID e Maturës Shtetërore. Për studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2006 të përdoret numri i regjistrit të veçantë të dëftesës së pjekurisë.

4.2 Diploma universitare Master i Shkencave ose Master Profesional e secilit student, duhet të përmbajë edhe numrin e diplomës së studimeve universitare të përfunduara më parë, përkatësisht studimeve të ciklit të parë (DNP), studimeve të integruara të niveli të dytë (DIND) ose studimeve universitare të sistemit të vjetër (Diplomë).”

II. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.17, datë 5.5.2011

PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2011

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7592, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të vendimit të Këshillit Ministrave nr.78, datë 8.2.2006 “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe provimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

KREU I

PROVIMET E DETYRUARA DHE ME ZGJEDHJE TË MATURËS SHTETËRORE

1. Provimet e Maturës Shtetërore 2011, të detyruara dhe me zgjedhje, të fillojnë në orën 10:00.
2. Testi për secilin nga provimet e detyruara përmban 25 pyetje, nga të cilat 13 kërkesa janë me përgjigje alternative dhe përbëjnë 13 pikë, dhe 12 kërkesa janë me zhvillim, të cilat vlerësohen me 37 pikë.
3. Testi për secilin nga provimet me zgjedhje të përmbajë 20 pyetje, nga të cilat 10 pyetje janë me përgjigje alternative dhe vlerësohen me 10 pikë dhe 10 pyetje janë me zhvillim, të cilat vlerësohen me 30 pikë.
4. Provimet e detyruara zgjasin 2 orë e 30 minuta secila. Procedurat e hartimit të testeve të provimeve të detyruara përcaktohen në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2011 në Republikën e Shqipërisë”, nr.33, datë 6.1.2011.
5. Provimet me zgjedhje zgjasin 4 orë. Procedurat e hartimit të testeve të provimeve me zgjedhje përcaktohen në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2011 në Republikën e Shqipërisë”, nr.33, datë 6.1.2011.
6. Për maturanët/kandidatët që do të japin provim të MSH-së njëri nga lëndët me zgjedhje, koha është 2 orë. Këta maturanët/kandidatë do të fillojnë provimin në orën 11:00 dhe do ta zhvillojnë atë në mjedise të veçanta.

KREU II

ADMINISTRIMI I PROVIMEVE

1. Administrimi dhe zhvillimi i provimeve të Maturës Shtetërore 2011 bazohet në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2011 në Republikën e Shqipërisë”.
2. Testet për provimet e Maturës Shtetërore hartohen dhe administrohen nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP), mbi bazën e programeve orientuese lëndore përkatëse.
3. DEPU-ja dhe AKP-ja, brenda muajit prill 2011, të përcaktojnë sasinë dhe llojin e testeve që nevojiten për secilin nga provimet e Maturës Shtetërore (të detyruara dhe me zgjedhje).

KREU III

HARTIMI DHE VLERËSIMI I TESTEVE TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2011

1. Përzgjedhja e testit për secilin nga provimet e detyruara dhe me zgjedhje të Maturës Shtetërore 2011, të kryhet nga specialistë të caktuar prej Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, të cilët emërohen përzgjedhës të testit përfundimtar (PTP) në kushtet e ruajtjes së plotë të sekretit, brenda ambienteve të izoluar të AKP-së. Pas përzgjedhjes së testit, të kryhet shumëfishimi dhe paketimi i test-broshurave nga AKP-ja.
2. Periudhat kohore të ekspozimit potencial të sekretit (KOEPS-eve) për Maturën Shtetërore 2011 të jenë:
 - a) 25 maj – 1 qershor 2011 për lëndën “Gjuhë shqipe dhe Letërsi”;
 - b) 8 qershor – 15 qershor 2011 për lëndën “Matematikë”;
 - c) 23 qershor – 30 qershor 2011 për lëndët me zgjedhje.
3. Lista e punonjësve të AKP-së, të cilët përfshihen në KOEPS për secilën periudhë të përmendur në pikën 2, kreu III i këtij udhëzimi, miratohet nga Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së. Specialistët e lëndëve përkatëse në AKP futen në KOEPS një ditë më pas nga datat e përcaktuara në pikën 2. Ata hartojnë së bashku me përgjegjësit e testeve të provimit (PTP) skemat e vlerësimit të testeve dhe ndihmojnë më tej proceset e tjera të formatimit, shumëfishimit dhe shpërndarjes së testeve.
4. Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA), Agjencia Kombëtare e Arsimit dhe Formimit Profesional (AKAFP) dhe Kulturë-Kontakt, të marrin masat e mëposhtme për lirimin e mjediseve dhe vënien e tyre në dispozicion të AKP-së, gjatë periudhës 24 maj - 1 korrik 2011:

- a) të zhvillojnë veprimtaritë e tyre në mjedise të tjera jashtë ndërtesës ku ndodhet AKP-ja;
- b) të planifikojnë lejet e zakonshme për specialistët, të cilët nuk janë angazhuar si përfaqësues të MASH-it për ndjekjen e provimeve të Maturës Shtetërore 2011.

5. Pas zhvillimit të çdo provimi të Maturës Shtetërore 2011, testet e maturantëve/kandidatëve të dërgohen nën masa të rrepta sigurie në godinën e shkollës “Sabaudin Gabrani”, Tiranë. AKP-ja kryen inventarizimin dhe shpërndarjen e tyre në qendrat e vlerësimit.

6. Vlerësimi i testeve të maturantëve/kandidatëve në provimet e Maturës Shtetërore 2011 të bëhet në qendrat e mëposhtme:

- a) në Tiranë në godinën e shkollës “Sabaudin Gabrani”, qendra nr.1;
- b) në Tiranë në godinën e shkollës “Sabaudin Gabrani”, qendra nr.2;
- c) në Elbasan në godinën e shkollës “Qemal Stafa”;
- ç) në Shkodër në godinën e shkollës “Jordan Misja”;
- d) në Fier në godinën e shkollës “Naim Frashëri”;
- e) në Korçë në godinën e shkollës “Sevasti Qiriazhi”.

7. Vlerësimi i testeve të Maturës Shtetërore 2011 të ndjekë procedurat e përcaktuara në nenin 58 të rregullores “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore 2011 në Republikën e Shqipërisë”, nr.33, datë 6.1.2011.

8. DAR Tiranë, DAR Elbasan, DAR Shkodër, DAR Fier dhe DAR Korçë të marrin masa për lirim të mjediseve për vlerësimin e testeve në godinat e shkollave të përmendura në pikën 6 të këtij kreu dhe për ruajtjen e tyre me shërbim 24-orësh me rojë të Policisë së Shtetit, gjatë periudhës 1 qershor - 15 korrik 2011.

9. Pas çdo provimi të Maturës Shtetërore 2011, në secilën nga 6 qendrat e vlerësimit, të funksionojë në mënyrë permanente një grup i administrimit dhe i monitorimit të testeve me përbërje si më poshtë:

- a) një përfaqësues i AKP-së;
- b) një përfaqësues i DEPU-së;
- c) një përfaqësues i DAR-së përkatëse.

10. AKP-ja të bëjë intervistimin dhe përzgjedhjen e vlerësuesve për çdo provim të Maturës Shtetërore dhe dërgon listat në DAR/ZA-të përkatëse brenda datës 15 prill 2011. Vlerësuesit e përzgjedhur të trajnohen nga AKP-ja sipas një programi e grafiku të posaçëm dhe të certifikohen në mbarim të këtij trajnimi.

11. Për drejtimin teknik të procesit të vlerësimit, AKP-ja të caktojë në çdo qendër e për secilin provim dy specialistë, të cilët do të përzgjidhen e trajnohen prej saj në periudhën 15 prill - 15 maj 2011.

12. Transporti i testeve nga Tirana për në secilën nga qendrat e vlerësimit Elbasan, Shkodër, Fier, Korçë dhe anasjellas, të bëhet nën masa të rrepta sigurie me automjete të DAR-së përkatëse nga grupi i administratorëve të përmendur në pikën 9 të këtij kreu.

KREU IV

MONITORIMI I PROCESIT TË KORRIGJIMIT TË PROVIMEVE TË MATURËS SHTETËRORE 2011

1. Grupi monitorues në Qendrën e Vlerësimit ka detyrat e mëposhtme:

- a) kontrollon nëse është siguruar ruajtja nga policia e objektit ku janë vendosur testet;
- b) përgjigjet për tërheqjen e testeve nga AKP-ja dhe për transportimin e tyre drejt Qendrës së Vlerësimit;
- c) merr në dorëzim testet nëpërmjet një procesverbali që firmoset nga tre përfaqësuesit e grupit monitorues, si edhe nga personi i sektorit të administrimit të testeve në AKP, i cili bën dorëzimin e tyre;
- ç) qëndron në mjediset e Qendrës së Vlerësimit gjatë procesit të korrigjimit dhe raporton në institucionet përkatëse.

2. Personat që bëjnë pjesë në grupet e monitorimit të procesit të korrigjimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2011 për secilën qendër vlerësimi, caktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

3. Periudha e monitorimit dhe grafiku i paraqitjes së përfaqësuesve të grupit monitorues në AKP është:

- a) për lëndën “Gjuhë dhe Letërsi shqipe” 3-13 qershor 2011;
- b) për lëndën “Matematikë” 17-30 qershor 2011;
- c) Për lëndët me zgjedhje 2-10 korrik 2011.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Punonjësit që angazhohen jashtë kohës normale të punës në procesin e administrimit dhe të vlerësimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2011, të paguhën sipas akteve nënligjore në fuqi.

2. Shpenzimet e udhëtimit, të hotelit dhe të ushqimit të specialistëve të përfshirë në këtë proces, mbulohen nga institucionet përkatëse.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, AKP-ja, IKAP-ja, IZHA-ja, AKAFP-ja, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.18, datë 11.5.2011

PËR MASAT PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË LIRIMIT 2011

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7592, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1013, datë 10.12.2010 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP)”,

UDHËZOJ:

1. Provimet e lirimit 2011 të fillojnë në orën 10:00 dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.
2. Procedurat e hartimit të testeve përcaktohen në rregulloren “Për zhvillimin e provimeve të lirimit në Republikën e Shqipërisë”, nr.592, datë 1.2.2011.
3. Në shkollat e pakicave kombëtare (greke dhe maqedonase) zhvillohet provimi i lirimit në gjuhën amtare.
 - a) Për shkollat e pakicës kombëtare greke teza do të përgatitet nga DAR Gjirokastrë, ZA Delvinë dhe ZA Sarandë, tërheqin në DAR Gjirokastrë tezën në ditën e provimit.
 - b) Për shkollat e pakicës kombëtare maqedonase teza përgatitet nga DAR Korçë dhe tërhiqet ditën e provimit nga drejtori i shkollës, i shoqëruar nga përfaqësuesi i DAR-së Korçë.
 - c) Hartimi i testit për provimin e lirimit në gjuhën amtare do të ndjekë të njëjtën procedurë sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.
4. Për Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë, testi të tërhiqet në AKP nga drejtoria e institutit një ditë para zhvillimit të provimit, që e kthen atë në sistemin e shkrimit BRAIL.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Koordinimit Rajonal, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, AKP-ja, IKAP-ja, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.449, datë 21.6.2011

PËR MËNYRËN E FUNKSIONIMIT TË KOMISIONIT TË VLERËSIMIT TË KËRKESAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT SHOQËRUES TË SHOQËRIVE QË DO TË PAJISEN ME LEJE PËR NDËRTIMIN E PËRDORIMIN E INFRASTRUKTURËS SË SISTEMEVE TË GAZIT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010 “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e procedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”, si dhe të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”,

URDHËROJ:

1. Komisioni i vlerësimit të kërkesave dhe të dokumentacionit shoqëruar të paraqitura nga shoqëritë që kërkojnë të pajisen me leje për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit, konstituohet

15 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij urdhri, me përbërje dhe drejtim sipas pikave 10 dhe 11 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010 dhe fillon funksionimin mbi bazën e njoftimit nga kryetari i komisionit.

2. Komisioni mbledhet për shqyrtimin e kërkesave brenda një periudhe prej 15 ditë pune nga data e depozitimit të kërkesës nga ana e shoqërive të interesuara. Data e mbledhjes caktohet nga kryetari i komisionit dhe njoftimi i anëtarëve bëhet jo më vonë se 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes.

3. Në mbledhjen e radhës së komisionit, shqyrtohen edhe kërkesa të tjera të ardhura deri 10 ditë para datës së mbledhjes së komisionit.

4. Njësia përgjegjëse për aktivitetin e sektorit hidrokarbur, në përbërje të strukturës së Ministrisë, bën trajtimin dhe përpunimin e dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë që kërkojnë të pajisen me leje për ndërtimin e përdorim e infrastrukturës së sistemeve të gazit, referuar përcaktimeve të pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, njofton komisionin, si dhe përgatit informacion për çdo kërkesë të depozituar.

5. Mbledhja e komisionit konsiderohet e vlefshme kur në të marrin pjesë jo më pak se $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të tij.

6. Anëtarët e komisionit nuk mund të përfaqësohen në mbledhje nga persona të tjerë. Në rastet kur për arsye të pashmangshme ndonjë nga anëtarët e komisionit nuk mund ta kryejë këtë funksion, komisioni plotësohet me anëtarin e caktuar nga ministri përkatës.

7. Në mbledhje mbahet procesverbali në të cilin pasqyrohet pjesëmarrja në komision, çështjet që diskutohen, diskutimet e anëtarëve të komisionit, si dhe vendimi që merret.

8. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur sipas pikës 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, duke pasur në konsideratë që:

a) në vlerësim për kredibilitetin financiar të subjektit, ai do të vlerësojë burimet e financimit, përfshirë edhe gjendjen në llogarinë bankare në momentin kur paraqitet kërkesa.

b) në vlerësimin për dokumentacionin e përvojës në fushën e ndërtimit dhe përdorimit të instalimeve bregdetare, ai do të vlerësojë dokumentacionin ku pasqyrohet eksperiencia dhe aktiviteti i deritanishëm në këtë fushë i shoqërisë kërkuese apo i bashkimit të shoqërive, ose i shoqërisë që do të zbatojë projektin, qoftë kjo *joint-venture* me shoqërinë investitore apo kontraktor i deklaruar nga shoqëria investitore.

9. Vendimi i komisionit është i vlefshëm në qoftë se për këtë vendim votojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të komisionit. Anëtarët e komisionit të cilët votojnë kundër shprehin qëndrimin e tyre në procesverbalin e mbledhjes.

10. Vendimi i komisionit, i cili merret brenda afatit prej 30 ditësh të përcaktuar në pikën 14.a të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, hartohet konform qëndrimit të shprehur dhe votimit të bërë dhe firmoset nga kryetari dhe të gjithë anëtarët e komisionit. Vendimi i paraqitet Ministrit për dhënien e subjektit kërkues të "Autorizimit të përkohshëm" për vazhdimin e procedurave për plotësimin e dokumentacionit teknik dhe ekonomik për projektin, si dhe për realizimin e praktikave përkatëse deri në marrjen e lejes.

Kryetari i komisionit njofton subjektin kërkues brenda 5 ditëve nga data e miratimit të "autorizimit të përkohshëm".

11. Subjekti i pajisur me "autorizim të përkohshëm" paraqet në Ministri, brenda afatit të përcaktuar në këtë "autorizim të përkohshëm", dokumentacionin e plotë të përcaktuar në pikën 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, për marrjen e lejes për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit.

12. Komisioni me marrjen e dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i interesuar, mbledhet dhe shqyrton atë në përputhje me detyrat e përcaktuara në pikën 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.713, datë 25.8.2010, duke marrë vendimet përkatëse.

13. Anëtarët e komisionit shpërblehen për çdo mbledhje të shqyrtimit të kërkesave në vlerën 10.000 lekë, kurse kryetari 15.000 lekë. Ky shpërblim do të sigurohet nga të ardhurat e Ministrisë, në mbështetje të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore".

14. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet njësia përgjegjëse për aktivitetin e sektorit hidrokarbur, si dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit.

Ky urdhër hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

URDHËR
Nr.478, datë 27.6.2011

**PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE PËRMBAJTJES SË VENDIMEVE TË KËSHILLAVE TEKNIKË
TË INSTITUCIONEVE TË SHGJSH-SË DHE AKBN-SË PËR APLIKIMET E LEJEVE MINERARE,
PËR SHTYRJEN E AFATIT TË LEJEVE MINERARE DHE PËR SHNDËRRIMIN E LEJEVE
MINERARE TË KËRKIM-ZBULIMIT NË LEJE MINERARE SHFRYTËZIMI**

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 43, pika 2, germa “e” të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe pikave 4 dhe 10, germa “A2” dhe “B2” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”,

URDHËROJ:

1. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), për çdo aplikim të ri për leje minerare të kërkim-zbulimit përshkruhen në aneksin 1 të këtij urdhri.

2. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), për kërkesat për shtyrje të afatit të një lejeje minerare të kërkim-zbulimit përshkruhen në aneksin 2 të këtij urdhri.

3. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, jo më vonë se 45 (dyzetepesë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim të ri për një leje minerare kërkim-zbulimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon oponencën teknike, shqyrton në Këshillin Teknik projektin e zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, programin minimal të punës për kërkim-zbulimin, projektin e rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare dhe dërgon në METE vendimin e miratimit ose mosmiratimit të Këshillit Teknik, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit, si dhe ka vulën e institucionit të SHGJSH-së.

4. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas, datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim për shtyrje afati të një lejeje minerare kërkim-zbulimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon vlerësimin në mënyrë dokumentare dhe në terren për realizimin e detyrimeve nga zotëruesit e lejeve minerare të kërkim-zbulimit, arsyet e shtyrjes së afatit, shqyrton në Këshillin Teknik këtë vlerësim dhe dërgon në METE vendimin e Këshillit Teknik të miratimit ose mosmiratimit për shtyrje në afat të lejes dhe të miratimit ose mosmiratimit të projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit për periudhën e shtyrjes së afatit, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit dhe ka vulën e institucionit të SHGJSH-së.

5. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për çdo aplikim të ri për leje minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit përshkruhen në aneksin 3 të këtij urdhri.

6. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për kërkesat për shtyrje të afatit të një lejeje minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit përshkruhen në aneksin 4 të këtij urdhri.

7. Forma dhe përmbajtja e vendimit të Këshillit Teknik të institucionit të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) për kërkesat për shndërrimin e një lejeje minerare të kërkim-zbulimit në një leje minerare shfrytëzimi, është e njëjtë në formë dhe përmbajtje me vendimin e Këshillit Teknik të këtij institucioni, sipas aneksit 3 të këtij urdhri, pasi ky shndërrim trajtohet si aplikim i ri. Zotëruesi i lejes së kërkim-zbulimit zotëron të drejtën e përparësisë që brenda periudhës kohore të përcaktuar në pikat 2 dhe 3, të nenit 12, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, të realizojë aplikimin për realizimin e këtij shndërrimi.

8. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim të ri për një leje minerare shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon oponencën teknike, shqyrton në Këshillin Teknik projektin e zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, programin e investimit për shfrytëzimin ose kërkim-zbulim-shfrytëzimin, projektin e rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimet për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit të investimit dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare, dhe dërgon në METE vendimin e miratimit ose

jomiratimit të Këshillit Teknik, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit dhe ka vulën e institucionit të AKBN-së.

9. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike pas datës së aplikimit në QKL për çdo aplikim për shtyrje afati të një lejeje minerare shfrytëzimi ose kërkim-zbulim-shfrytëzimi, vlerëson kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin, realizon vlerësimin në mënyrë dokumentare dhe në terren, për realizimin e detyrimeve nga zotëruesit e lejeve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit, arsyet e shtyrjes së afatit, shqyrton në Këshillin Teknik këtë vlerësim dhe dërgon në METE vendimin e Këshillit Teknik të miratimit ose jomiratimit për shtyrje në afat të lejes dhe të miratimit ose jomiratimit të projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të shfrytëzimit ose kërkim-zbulim-shfrytëzimit për periudhën e shtyrjes së afatit, i cili firmoset nga Sekretari i Këshillit Teknik dhe titullari i institucionit dhe ka vulën e institucionit të AKBN-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Nasip Naço

ANEKSI 1



Këshilli Teknik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

VENDIM

Nr. _____ datë ____/____/20....

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, programit minimal të punës për kërkim-zbulimin, projektit të rehabilitimit të zonës minerare dhe përcaktimeve për vlerat e garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare

për aplikimin në QKL për leje minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../....., të subjektit, në zonën minerare nr.....

Në zbatim të nenit 43, pika 2, germa "e" të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", pikave 4 dhe 10, germa "A2" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 "Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura" dhe kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.364, datë 4.5.2011 "Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare", Këshilli Teknik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) në mbledhjen e tij të datës .../.../.....

A. Pasi:

1. U njoh me vlerësimin për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin për leje minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../....., të subjektit, në zonën minerare nr.....

2. U njoh me aktverifikimin e realizuar nga grupi i punës i SHGJSH-së.

3. Dëgjoi paraqitjen e projektit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit nga

4. Dëgjoi oponencën e projektit kryer nga.....

5. Shqyrtoi autenticitetin dhe burimin ligjor të informacionit të të gjithë dokumentacionit gjeologjik në përmbajtjen e dosjes së projektit.

6. Shqyrtoi përmbajtjen e projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, në përmbushjen e kriterëve ligjore dhe shkencore në tërësinë e tij.

7. Shqyrtoi programin minimal të punës të kërkim-zbulimit paraqitur në projekt.

8. Shqyrtoi projektplanin e rehabilitimit të zonës minerare: i) projektin e veprimtarive të mbylljes; ii)

projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare; iii) projektin e rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të zonës minerare.

9. Shqyrtoi vlerën e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës.

10. Shqyrtoi vlerën e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit të zonës minerare.

B. Vlerësoi se:

1. Aplikimi për leje minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../..., i dorëzuar në QKL nga ana e subjektit, për zonën minerare nr..... plotëson/nuk plotëson kushtet e lejimit sipas dokumenteve vërtetuese të paraqitura nga subjekti në përputhje me kërkesat ligjore të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”; dhe urdhrave të ministrit të dala në zbatim të tyre për të vijuar procedurat e pajisjes me leje minerare kërkim-zbulimi (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

2. Nga aktverifikimi i kryer (aneksi 2, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010), plotësohen/nuk plotësohen kërkesat ligjore për të vijuar procedurat e pajisjes me leje minerare kërkim-zbulimi në zonën e kërkuar minerare, në përputhje me ligjin nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

3. Nga dëgjimi i paraqitjes së projektit të zhvillimit të aktiviteteve minerare të kërkim-zbulimit, oponencës teknike të tij, pyetjeve dhe diskutimeve vlerësohet se projekti plotëson/nuk plotëson kërkesat ligjore dhe teknike në përmbajtjen e tij (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

4. Projekti me titull “.....” i hartuar nga subjekti “.....” dhe paraqitur së bashku me aplikimin për leje minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../..., për zonën minerare nr....., sipas përmbajtjes së tij, është/nuk është ndërtuar në përputhje me kërkesat e pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”; pikës 1 dhe 10, germa “A1” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”, dhe kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.364, datë 4.5.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit dhe të prodhimit për një leje minerare” dhe paraqet fazat: Kërkimi për periudhën (.../.../.....-.../.../.....), zbulimi për periudhën (.../.../.....-.../.../.....), dhe/ose direkt zbulimi për periudhën (.../.../.....-.../.../.....), dhe/ose kërkim-zbulimi njëkohësisht për periudhën (.../.../.....-.../.../.....).

5. Dokumentacioni gjeologjik i përdorur për hartimin e projektit që përfshihet në dosjen e projektit, sipas deklaramit të vetë subjektit, verifikimit të tij nga oponenca teknike dhe Këshilli Teknik është/nuk është siguruar nga arkiva qendrore e SHGJSH-së, AKBN-së, në përputhje me rregullat në fuqi; apo është/nuk është siguruar apo plotësuar nga një burim tjetër ligjor informacioni në përputhje me kërkesat e pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.942, datë 17.11.2010 “Për miratimin e procedurave dhe të dokumentacionit për marrjen e lejeve minerare në zonat e hapura”.

6. Programi minimal i punës, mbështetet në projektin e veprimtarisë të kërkim-zbulimit të përpiluar dhe për sipërfaqen prejkm²: programon shpenzimin financiar që mbulon këtë program minimal pune sipas zërave, objekteve dhe në total të vlerës prej (.....). Kjo vlerë, për sipërfaqen e kërkuar të lejes minerare të kërkim-zbulimit dhe për periudhën kur duhet të realizohen programi minimal i punës për veprimtarinë e kërkim-zbulimit është/nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 13, pikat 1 dhe 2; nenit 14, pika 4; nenit 20, pika 1 germa “a” të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, dhe kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.364, datë 4.5.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”.

7. Projekti i rehabilitimit të zonës minerare me shpenzimet financiare të programuara për rehabilitim në vlerën prej (.....) është/nuk është hartuar në përputhje me legjislacionin minerar dhe atë mjedisor, dhe përmban/nuk përmban: i) projektin e veprimtarive të mbylljes; ii) projektin e menaxhimit të mbetjeve minerare, iii) projektin e rehabilitimit progresiv dhe përfundimtar të zonës minerare, me shpenzimet përkatëse (mangësitë nëse ka).

8. Për realizimin e programit minimal të punës, projekti i veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit ka/nuk ka përcaktuar drejt, vlerën e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës.

9. Për realizimin e planit të rehabilitimit, projekti i veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit ka/nuk ka përcaktuar drejtë, vlerën e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit.

Në vlerësim të sa më sipër, Këshilli Teknik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

VENDOSI:

1. Aplikimi për leje minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../....., i dorëzuar në QKL nga ana e subjektit, për zonën minerare nr..... plotëson/nuk plotëson kushtet e lejimit sipas dokumentacionit vërtetues të paraqitur nga subjekti për të vijuar procedurat e pajisjes me leje minerare kërkim-zbulimi (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

2. Aktverifikimi për zonën minerare plotëson/nuk plotëson kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

3. Projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit për zonën minerare nr. është /nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

4. Projekti i rehabilitimit të zonës minerare të kërkim-zbulimit nr. (pjesë e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit) është /nuk është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit minerar dhe atij mjedisor (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

5. Dokumentacioni gjeologjik i përdorur për hartimin e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit është/nuk është siguruar në përputhje me kërkesat dhe rregullat në fuqi për marrjen e të dhënave gjeologjike dhe minerare (arsyet në rast mosplotësimi të kërkesave).

6. Të miratjës/mos miratjës projektin e zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit sipas dokumentacionit të paraqitur në aplikimin për leje minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../....., të subjektit, në zonën minerare nr..... (arsyet e mosmiratimit).

7. Të miratjës këto kondita specifike për zhvillimin e veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit si detyruese për subjektin aplikues në rast të përfitimit të lejes minerare të kërkim-zbulimit (kushte që përfshijnë përcaktimin e variantit optimal të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit, në rastet kur projekti i zhvillimit të veprimtarive minerare jepet me disa variante, problematikat e rrezikut gjeologjik, të sigurisë në punë, mbrojtjes së shëndetit të punonjësve, mjedisit, trajtimit të mbetjeve, dëmtimit të tokës etj.).

1....., 2....., 3....., 4..... etj.

8. Mbështetur në projektin e veprimtarisë të kërkim-zbulimit dhe fazave të zbatimit të tij, shpenzimet për realizimin e programit minimal të punës dhe atij të investimit sipas viteve janë:

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Faza sipas llojit të aktivitetit	Shpenzimet për programin minimal	Shpenzimet për programin e investimit
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza.....
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza.....
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza.....
Periudha (.../.../.....-.../.../.....) Viti i	Faza.....
.....
Totali

9. Koordinatat në plan të zonës së lejuar minerare për zhvillimin e veprimtarisë së kërkim-zbulimit janë:

X	Y
.....
.....
.....

Sipërfaqja e zonës së lejuar..... km².

10. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit gjatë periudhës së programit minimal të punës sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit do të përmbajë këto operacione pune (1.....; 2.....; etj.) me një vlerë totale prej (.....) dhe vlerë vjetore (.....).

11. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit do të realizohet për kërkim-zbulimin e mineraleve (1.....; 2.....; etj.).

12. Afati fillestar i lejes minerare të kërkim-zbulimit është (.....vjet).

13. Veprimtaria minerare e kërkim-zbulimit gjatë gjithë periudhës fillestare të lejes minerare së programit të investimit sipas projektit të zhvillimit të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit do të përmbajë

këto operacione pune (1.....; 2.....; etj.) me një vlerë totale prej (.....) dhe vlerë vjetore (.....).

14. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës e miratuar me këtë vendim është (.....).

15. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e programit minimal të punës e miratuar me këtë vendim është (.....).

16. Vlera totale e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit e miratuar me këtë vendim është (.....).

17. Vlera vjetore e garancisë financiare për realizimin e planit të rehabilitimit e miratuar me këtë vendim është (.....).

Vendimi i Këshillit Teknik të SHGJSH-së nr....., datë....., vlerësimi për kushtet e lejimit, oponenta e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të kërkim-zbulimit, së bashku me aktin e verifikimit për lejen minerare të kërkim-zbulimit për objektin: (emri i objektit minerar), vendburimin e (emri i vendburimit/masivit) në qarkun (emri i qarkut/rrethit) përfshirë në zonën minerare nr. (numri i zonës minerare të shpallur në hartën e planit vjetor minerar), të publikuar në hartën e planit vjetor minerar të vitit....., i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në datën, për procedurat e mëtejshme të vlerësimit të aplikimit të lejes minerare.

Sekretari i Këshillit Teknik

Firma

Drejtori i Përgjithshëm i SHGJSH-së

Firma/ vula

ANEKSI 2



Këshilli Teknik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar

VENDIM

Nr. _____ datë ___/___/20....

Për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit për zgjatje afati të lejes minerare të kërkim-zbulimit nr., datë .../.../....., të subjektit, në zonën minerare nr.....

Në zbatim të neneve 13 dhe 14, pika 2 të ligjit nr.10 304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, pikës 10 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.362, datë 29.4.2011 “Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare” dhe kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.364, datë 4.5.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të vlerës minimale të sipërfaqes së zonës së lejuar minerare dhe të vlerës minimale të investimit e të prodhimit për një leje minerare”, Këshilli Teknik i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) në mbledhjen e tij të datës .../.../.....

A. Pasi u njoh me:

1. Kërkesën e subjektit..... për shtyrje afati të lejes minerare të kërkim-zbulimit nr., datë .../.../....

2. Vlerësimin për kushtet e lejimit dhe dokumentet vërtetuese për aplikimin për shtyrje të afatit të lejes minerare kërkim-zbulimi nr., datë .../.../....., të subjektit, në zonën minerare nr.....

3. Raportin përfundimtar të veprimtarisë së kërkim-zbulimit të kryer nga subjekti me punimet e kryera, rezultatet e fituara shoqëruar me vizatimet e duhura inxhinierike.

4. Vlerësimin dokumentar dhe në terren të veprimtarisë minerare të kërkim-zbulimit të përgatitur nga specialistët e grupit të punës të SHGJSH-së për punën e realizuar nga subjekti, sipas zërave të tyre në zbatim të projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare dhe të detyrimeve të lejes minerare të kërkim-zbulimit nr., datë .../.../....., për zonën minerare nr.....

5. Vlerësimin e grupit të mbikëqyrjes dhe monitorimit të SHGJSH-së mbi dorëzimin e informacioneve për punimet e kryera dhe rezultatet e fituara, në respektimin e kërkesave të urdhrave të ministrit nr.307, datë 13.4.2011 “Për miratimin e formës së informacioneve tremujore, vjetore, përfundimtare dhe përmbajtjen e planit vjetor të punës nga ana e zotëruesve të lejeve minerare të kërkim-zbulimit për grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet” dhe nr.312, datë 13.4.2011 “Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së informacioneve të detyrueshme që përgatiten nga zotëruesit e lejeve minerare”.

6. Vlerësimin e grupit të mbikëqyrjes dhe monitorimit të SHGJSH-së mbi dorëzimin në afat të garancive financiare për realizimin e programit minimal të punës dhe realizimin e planit të rehabilitimit.

